



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit




Nr 01.400/01-18066 dt. 03. 04 2019

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h)të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 6 nënparagrafit 2.1 të Ligjit nr.04/L-010 për Bashkëpunim Ndër komunal dhe nenit 5 nënparografi 1.1 dhe Rregullores nr.09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Nder komunal, Kryetari i Komunës së Drenasit, paraqet këtë kërkesë për miratim:

NISMËN

PER BASHKEPUNIM NDËR KOMUNAL ME KOMUNEN E SKENDERAJIT NE FUSHEN E INFRASTRUKTURES

1. Bashkëpunimi ndër komunal do të zhvillohet me komunën e Skenderajt.
2. Qëllimi i bashkëpunimit- bashkëpunimi do të bëhet në fushën e Infrastrukturës duke ofruar dhe pranuar shërbime në fushën e Infrastrukturës.
3. Bashkangjitur me nismën gjeni propozim – vendimin për miratimin e nismës nga Kuvendi i Komunës



A R S Y E T I M

Nismat për vendosjen e bashkëpunimit ndër komunal mund ta marrin organet komunale, institucionet qendrore dhe organizatat e shoqërisë civile që merren me fushën e vetëqeverisjes lokale.

Komunat hyjnë në bashkëpunim me komunat tjera në funksion të zhvillimit më të shpejtë ekonomik lokal, të efikasitetit dhe efektivitetit të ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit bashkëpunimi komunal ndërkontrolltar është kufizuar vetëm në aspektin administrativ dhe teknik.

Komunat e përfshira në cilën do formë të BNK veç e veç dhe bashkërisht mbajnë përgjegjësi juridike për të gjitha veprimet dhe aktet juridike që rezultojnë nga bashkëpunimi në fjalë.

Po ashtu komunat janë të kufizuara të ndërmarrin veprimet për lidhjen e bashkëpunimit ndër komunal dhe bashkëpunimit komunal ndërkontrolltar, në rast se dalim jashtë kompetencave vetanake të përcaktuara me legjislacionin për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës, Çdo bashkëpunim duhet të këtë për qellim interesin e përbashkët të komunave.

Bashkëpunimi ndër komunal në Republikën e Kosovës edhe normuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Bashkëpunim ndër komunal si dhe aktet tjera për zbatimin e këtij ligji.

Për realizimin e qëllimeve dhe interesave të përbashkëta lidhur me ushtrimin e kompetencave të tyre vetanake sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dy apo me shumë komuna kanë të drejtë të hyjnë në marrëdhënie bashkëpunimi në pajtim me parimet, format, kushtet dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin e lartshënuar.

Me respekt!